



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 14.08.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 08.08.2019, të parashtruar nga Operatorëve Ekonomik 1. "DWH ALBANIA" shpk, 2. "DWH KOSOVA", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Instrument GPS", me Nr. të Prok: 632-19-5928-1-3-6 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorëve Ekonomik 1. "DWH ALBANIA" shpk dhe 2. "DWH KOSOVA" shpk, e dt. 08.08.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Instrument GPS", me Nr. të Prok: 632-19-5928-1-3-6, kundër kundër dosjes së tenderit, te AK –së, të datës 07.08.2019 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .

2. Vërtetohet NJOFTIM PËR KONTRATË DHE DOSJA E TENDERITI AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 07.08.2019;

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://www.e-prokurimi.rks-gov.net/>

Arsyetim

Operatorët Ekonomik 1. "DWH ALBANIA" shpk dhe 2 "DWH KOSOVA" shpk, me datë 08.08.2019, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Instrument GPS", me Nr. të Prok: 632-19-5928-1-3-6. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 14.08.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Sa i përket numrit të kanaleve, AK ka kërkuar që marrësit të mos ketë me pake se 226 kanale, pothuajse të gjithë prodhuesit e pajisjeve gjeodezike, përfshirë ato që janë prodhues Amerikan, Evropë dhe ato që janë nga Azia e largët, të gjithë prodhuesit kanë rover që ka 226 kanale ose me shumë. Andaj pohimi i OE-se se kemi përjashtuar 95% të prodhuesve është një e pavërtetë e madhe. Nëse OE nuk don të ofertoj rover me 226 kanale ose me shumë, ky është problem i tyre, jo i specifikimeve. Kurse në lidhje me prodhimin e OS-se se në hemisferën qenkan vetëm 30 satelit dhe nuk ka arsye për shumë kanale, themi pajisjet me më shumë kanale janë shumë here me të mirë se ato që kanë me pake, këtë pohim e din jemi të bindur që ka shumë të qartë edhe OE, pamarre përsysh se këtu OE tenton të sillet sikurse kemi kërkuar diçka kote. Sa me shumë kanale kemi kapje të satelitit me shpjeg, roveri punon në vende sfiduese dhe ofron rendiment me të lartë në punë.

2. Edhe në këtë pikë I nderuar OE, nuk është ashtu siç ju thoni, prodhuesit me të mirë, që ju i dini mirë se cilët janë, ofrojnë që pajisje në sistemin operative windows 10. Nuk është e vërtetë se vetëm një prodhues ofron windows 10, të gjithë prodhuesit prodhojnë kontrollor me windows 10, ndërsa pse ju ofertoni android është problemi tek ju e jo tek specifikat.

Konkluzion: AK-ja ka kërkuar produkte duke u bazuar në pikat me të rëndësishme të një pajisje gjeodezike, nuk është e vërtetë që ka favorizuar vetëm një prodhues, të gjithë prodhuesit madje edhe prodhuesi që OE përfaqëson ofron produkte me këto specifika që janë kërkuar

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Arkivitet të Komunës

Faton Guta
Menaxher i Zyrës së Prokurimit